



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për “Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian””.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.7.2024, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të zbardhura të dy mbledhjeve të mëparshme, datë 14 dhe 21 qershor të vitit 2024.

2. Informimi për zbatimin e vendimeve të mbledhjes së datës 21 qershor të vitit 2024.

3. Vendimmarrje organizative lidhur me procesin përgatitor për organizimin dhe funksionimin e komisionit të posaçëm parlamentar dhe grupit të ekspertëve pranë tij:

i) projektvendimi për “Ftesë për bashkëpunim” drejtuar grupeve parlamentare të Kuvendit, që të propozojnë përfaqësuesit/ekspertët e tyre pranë tre nëngrupeve të GE-së dhe ST-së.

ii) Projektvendimi për “Ftesë për bashkëpunim” drejtuar institucioneve, organeve dhe organizatave që veprojnë brenda sistemit të drejtësisë, që të propozojnë përfaqësuesit/ekspertët e tyre pranë nëngrupit përkatës të GE-së dhe ST-së.

iii) Projektvendimi për “Ftesë publike për bashkëpunim” drejtuar organeve të medias audiovizive, medias së shkruar, medias *online* dhe asaj elektronike, që të shprehin interesin për të kontribuar me ekspertizën e tyre në veprimtaritë e komisionit të posaçëm parlamentar dhe grupeve të ekspertëve.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Erion Braçe, Milva Ekonomi, Klotilda Bushka, Etilda Gjonaj, Evis Kushi dhe Toni Gogu.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Dhurata Tyli (Çupi), Flutura Aça, Sorina Koti dhe Eduard Shalsi.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Siç jeni njoftuar, meqenëse plotësohet kuorumi i nevojshëm, sipas Rregullores, fillojmë mbledhjen e komisionit të posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për “Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian””, mbështetur në rezolutën e Kuvendit dhe në vendimin nr.50 të këtij viti, të marrë nga Kuvendi i Shqipërisë.

Pika e parë e rendit të ditës është: miratimi i procesverbaleve të zbardhura të dy mbledhjeve të mëparshme, datë 14 dhe 21 qershor të vitit 2024.

A ka ndonjë koment apo sugjerim lidhur me procesverbalet? Jeni dakord? Nuk ka.

Miratohen.

Pika e dytë është: informimi për zbatimin e vendimeve të mbledhjes së mëparshme, datë 21 qershor të vitit 2024. Komisioni ka marrë disa vendime, që kryesisht janë vendime me karakter organizativ, dhe kanë të bëjnë me procesin përgatitor për krijimin e normalitetit të punës së komisionit të posaçëm dhe strukturave që do të ngrihen pranë tij, siç është adresimi, me ftesë publike për bashkëpunim, ndaj organizatave ndërkombëtare që veprojnë brenda dhe jashtë vendit, individëve, ekspertëve ndërkombëtarë dhe shtetasve shqiptarë jashtë vendit për t’u ofruar, për të shprehur interes, për të asistuar dhe për të ofruar ekspertizë në rolin e konsulentit në të 3 fushat që janë objekt i punës së këtij komisioni, rrjedhimisht edhe në tri nëngrupet e këtij komisioni.

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgatitur ftesat:

Së pari, ftesa, duke qenë se është ftesë publike, do të publikohet në faqen e *web*-it të komisionit, që besoj se në fund të kësaj jave do të jenë eficiente dhe e përdorshme jo vetëm për ne, por edhe për publikun e gjerë, pa dyshim, edhe për njoftime të kësaj natyre.

Vendimi tjetër i komisionit ishte adresimi i kërkesës për bashkëpunim kundrejt institucioneve publike, të cilat ushtrojnë funksione në fusha me risk për korrupsion, sipas vlerësimeve që bëhen nga vetë raportet e Bashkimit Europian, kryesisht në fushën e prokurimeve publike, koncesioneve, shëndetësisë, arsimit, tatimeve, doganave, kadastrës e të tjerë. Komisioni ua ka dërguar kërkesat dhe pothuajse të gjitha institucionet kanë kthyer përgjigje, duke përcaktuar përfaqësuesit e tyre që do të atashohen dhe do të veprojnë pranë nëngrupeve, sidomos grupit të ekspertëve që do të merret me çështjet e korrupsionit. Njëkohësisht, na kanë vënë në dispozicion

edhe një sërë dokumentesh, që do të jenë të nevojshme për t'u shqyrtuar, sidomos gjatë procesit të analizës.

Gjithsesi, për korrektesë dhe informim të kolegëve, por edhe për informim të palëve të interesuara dhe opinionit publik, në zbatim të vendimeve të këtij komisioni, të marra në mbledhjet e mëparshme, u kemi dërguar ftesa për bashkëpunim rreth 15 organizatave të shoqërisë civile, rreth 8 fakulteteve të universiteteve publike dhe jopublike, 8 shoqatave dhe organizatave përfaqësuese të komunitetit të biznesit, 10 institucioneve të pavarura, gjithashtu, 10 agjencive ligjzbatuese, ndërkohë janë përgatitur edhe ftesat për rreth 10 organizata ndërkombëtare dhe misione të asistencës që veprojnë në Shqipëri dhe jashtë vendit, një pjesë e tyre kanë shprehur interes për t'u përfshirë në këtë proces.

Kjo është pak a shumë një pasqyrë e përgjithshme.

Duke qenë se këtë javë përmbyllet procesi i kthimit të përgjigjeve nga institucionet, besoj se shumë shpejt do të kemi një vendimmarrje për ta formalizuar grupin e ekspertëve, me të tre nëngrupet e tij, si dhe sekretariatit teknik, me të gjithë skuadrën që do të punojë në mbështetje të punës së grupit të ekspertëve.

Dua të falënderoj stafin e Kuvendit, që është pjesë e sekretariatit teknik, posaçërisht zonjat që janë marrë me analizën e raporteve ndërkombëtare, kryesisht atyre të BE-së, lidhur me vlerësimet, gjetjet dhe rekomandimet që kanë të bëjnë me këto tri fusha që kemi objekt të punës së këtij komisioni!

Gjithashtu, një falënderim të veçantë dua t'ia bëj Institutit të Kërkimeve Parlamentare (besoj se e shqiptova saktë), drejtuesit dhe ekipit të tij, për studimin që kanë bërë për të parë përvojat që ekzistojnë aktualisht, kryesisht në modele të tjera të vendeve që janë të ngjashme me ne, të cilat kanë të bëjnë me adresimin e çështjeve të luftës kundër korrupsionit! Unë besoj se për kërkimet e Institutit ky është vetëm fillimi. Materiali është shumë i dobishëm dhe do t'u vihet në dispozicion, në radhë të parë, anëtarëve të komisionit, por edhe ekspertëve që do të merren me këtë gjë.

Nga ana tjetër, besoj se zonjat dhe zotërinjtë që janë pjesë e skuadrës që punon me Institutin, do ta vazhdojnë punën e tyre kërkimore, për ta thelluar më tej dhe për të hyrë në disa detaje, që kanë të bëjnë me procese të ngjashme që janë zhvilluar në këto vende, kryesorja dhe mbi të gjitha, mbi produktet që kanë dalë nga këto procese, të cilat do të jenë një vlerë e shtuar për grupet e ekspertëve.

Po ashtu dua të falënderoj edhe pjesën e stafit që merret me mbështetjen e komisionit dhe komunikimin publik, për impenjimën që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë, në përgjigje të detyrave që kanë marrë përsipër!

Edhe një herë, shumë faleminderit!

Vazhdojmë me pjesën tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me disa vendimmarrje të rëndësishme, që lidhen me procesin përgatitor, që kryesisht janë të natyrës organizative, por që theksojnë më së miri 4 elementet bazike, themelore dhe përcaktuese të gjithë këtij procesi, që janë: gjithpërfshirja, transparencë, profesionalizmi dhe standardet në zhvillimin e këtij procesi dhe në produktet që do të dalin prej tij. Në funksion të këtij qëllimi, projektvendimi i parë që dëshiroj t'ju propozoj, që është hartuar nga këshilltarët e komisionit, të ngarkuar nga Kuvendi për të asistuar punën e këtij komisioni, ka të bëjë me përfaqësimin e grupeve parlamentare me përfaqësues dhe ekspertë, pranë tre nëngrupeve të punës së ngritur në komisionin e posaçëm parlamentar.

Bazuar në nenin 24 të Rregullores së Kuvendit dhe në pikën 8, paragrafi 2, të vendimit nr. 50 të Kuvendit, për krijimin e këtij komisioni të posaçëm, propozoj që ky komision i posaçëm t'u drejtohet grupeve parlamentare të regjistruara në Kuvend, që, nëse e çmojnë të arsyeshme, të propozojnë përfaqësuesit, ekspertët, me të cilët dëshirojnë të përfaqësohen, për të prezantuar kontributet përkatëse në emër të grupeve të tyre parlamentare, pranë grupit të ekspertëve dhe sekretariatit teknik, struktura të ngritura pranë komisionit të posaçëm parlamentar, konform parashikimit të vendimit nr. 50 të Kuvendit.

Pika 2. Secili grup parlamentar mund të propozojë vetëm një përfaqësues, ekspert, pranë çdonjërit prej tre nëngrupeve të grupit të ekspertëve dhe tre nëngrupeve të sekretariatit teknik. Kjo ishte për ta bërë të qartë, se për kolegët është e qartë, por edhe për transparencë publike. Ideja është që secili nga grupet parlamentare të mund të dërgojë një përfaqësues apo ekspert pranë secilit nga grupet. Pra, çdo grup parlamentar mund të sjellë tre ekspertë të vetët, nga një pranë secilin nëngrup, si për grupin e ekspertëve, ashtu edhe sekretariatit teknik, të cilët, natyrisht, nuk do të jenë anëtarë të këtyre grupeve, por të atashuar pranë tyre dhe do të mund të prezantojnë pikëpamjet e grupeve të tyre politike për çështjet që debatohen, diskutohen dhe vendimet që merren në grupin e ekspertëve. Kjo edhe për shkak se ajo është një tribunë, siç është konceptuar, që do të jetë një mekanizëm, i cili do të funksionojë në liri të plotë dhe i pavarur në vendimmarrjet e veta, që do t'i propozohet pastaj komisionit për shqyrtim. Është shumë mirë që ata të njohin edhe pikëpamjet e

grupeve politike parlamentare gjatë procesit të hartimit dhe përmbylljes së drafteve që do t'i paraqiten komisionit për shqyrtim. Kush është dakord? Ka ndonjë koment?

Po, zoti Braçe.

Erion Braçe – Ne kemi një anomali në Kuvend dhe e kemi në krahun e opozitës. Jo të gjithë deputetët e opozitës janë të përfaqësuar në grupe parlamentare. Ky është një realitet i ri që ka ndodhur javët e fundit. Kështu që, do të duhet të gjejmë një mundësi se si edhe këta deputetë, që nuk përfaqësohen në grupe parlamentare, të kenë mundësi që edhe të jenë pjesë, por edhe të informohen lidhur me këtë gjë.

Fatmir Xhafaj – Ndoshta është një çështje që duhet diskutuar, por duhet të kini parasysh që në vendimin nr. 50 të Kuvendit, në pikën 12, ne kemi parashikuar që çdo parti tjetër jo parlamentare, që nuk është përfshirë në këtë komision, do të ftohet të marrë pjesë në aktivitetet e hapura, si dhe të ofrojë kontribute konkrete pranë komisionit dhe grupit të ekspertëve. Kjo nënkupton që edhe partitë e tjera parlamentare, pavarësisht se mund të mos jenë grup, për më tepër ato, jemi të detyruar t'i ftojme dhe t'u kërkojmë të ofrojmë kontribute. Si mund ta bëjmë këtë gjë? Nuk mundet që secilit nga ata, duke mos qenë një grup i regjistruar në formën e njohur nga Rregullorja e Kuvendit, t'i kërkojmë të atashojë një ekspert, por ne do të japim mundësinë, që deputetët që mund të kenë ide, mendime dhe propozime lidhur me dokumentet që grupet e ekspertëve do të shqyrtojnë dhe ne do të miratojmë, të shprehen ose në një mbledhje të hapur të këtij komisioni, ose në një tryezë të organizuar nga ky komision, ose drejtpërdrejt me propozime konkrete. Unë kam pas rastin që disa nga kolegët deputetë më kanë kërkuar që, në një moment të përshtatshëm, të paraqiten në komision se dëshirojnë të shfaqin pikëpamjet e tyre për çështje të ndryshme. Sigurisht që janë të mirëpritur, sepse askush nuk e ndalon deputetin, në çdo kohë dhe konform Rregullores dhe procedurave përkatëse, të marrë pjesë në aktivitete të kësaj natyre. Gjithsesi, duhet parë se si mund ta vendosim në një procedurë normale, barazie për të gjithë, gjithë këtë angazhim dhe kontribut, jo vetëm të grupeve parlamentare, por edhe të kolegëve të tjerë deputetë, që janë pjesë e Parlamentit apo partive jashtëparlamentare, siç është theksuar në vendimmarrjen e Kuvendit.

Biem dakord? Zoti Braçe, jemi dakord?

Erion Braçe – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ka koment tjetër? E miratojmë, atëherë?

Miratohet.

Faleminderit!

Projektvendimi i dytë është “Për përfaqësimin e institucioneve të drejtësisë me përfaqësues ekspertë dhe profesionistë pranë grupit të ekspertëve dhe të sekretariatit teknik në komisionin e posaçëm parlamentar”. Bazuar në nenin përkatës të Rregullores së Kuvendit, në rezolutën e Kuvendit dhe në pikën 8 të vendimit nr.50, komisioni i posaçëm parlamentar vendosi:

1. T’u drejtohet me një ftesë për bashkëpunim të gjitha institucioneve dhe organeve, që janë pjesë të sistemit të drejtësisë, që ushtrojnë funksione në fushën e drejtësisë, të propozojnë përfaqësuesit e tyre me të cilët duhet të përfaqësohen për të asistuar dhe kontribuar në çështjet dhe veprimtaritë e kësaj fushe, që do të trajtohen e zhvillohen nga komisioni i posaçëm parlamentar. Këtu është fjala, që të jemi të qartë, për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Strukturën e Posaçme Antikorrupsion, Prokurorinë e Përgjithshme, Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Shkollën e Magjistraturës në qoftë se nuk kam harruar ndonjë tjetër.

2. Të ftojë gjithashtu institucionet e lartpërmendura që të propozojnë ekspertët e tyre më të mirë nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve avokatëve, pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës e të tjera, të cilët do të krijojnë nëngrupin e ekspertëve pranë grupit të ekspertëve, strukturë e cila do të angazhohet me hartimin e analizës për sundimin e ligjit në fushën e drejtësisë, hartimin e planit përkatës të veprimit, si dhe do të sugjerojë propozime të mundshme ligjore dhe institucionale, që do t’i propozohen komisionit të posaçëm parlamentar për shqyrtim dhe miratim. Në mbështetje të punës së ekspertëve, institucionet ftohen të propozojnë nga radhët e stafit, këshilltarëve dhe asistentëve të tyre profesionistë që do të krijojnë nëngrupin e punës përkatës të ngritur pranë sekretariatit teknik. Nga përmbajtja e këtij projektvendimi, këtu koncepti është paksa i ndryshëm nga ai që kemi miratuar në mbledhjen e mëparshme, por që buron edhe nga fryma e rezolutës dhe e vetë vendimit, që nënkupton se këto institucione do të krijojnë një nëngrup pranë grupit të ekspertëve dhe me përfaqësues nga stafet profesioniste të tyre, që do të ndihmojnë këtë nëngrup pranë sekretariatit teknik. Pra, janë ata vetë, të cilët do të diskutojnë për çështjet që kanë sot në fushën e veprimit të tyre, janë ata vetë që do të punojnë së bashku me grupin e ekspertëve për analizën dhe po ata vetë, përmes një debati dhe një diskutimi të brendshëm dhe publik, sipas frymës së rezolutës dhe vendimit të Kuvendit, do të miratojnë analizën për fushën e tyre dhe më pas planin e veprimit dhe propozimet përkatëse. Kjo është përmbajtja e këtij projektvendimi.

Keni komente për këtë gjë? Nuk ka komente.

Miratohet.

Projektvendimi tjetër është “Ftesë publike për bashkëpunim, drejtuar organeve të medias audiovizive, medias së shkruar, medias *online* dhe asaj elektronike, për të shprehur interesin për të kontribuar me ekspertizën e tyre në veprimtarinë e komisionit të posaçëm parlamentar dhe grupit të ekspertëve”. Bazuar në frymën e rezolutës, nenet përkatëse të Rregullores së Kuvendit dhe në pikën 8 të vendimit nr. 50 të Kuvendit, komisioni i posaçëm parlamentar vendosi t’u drejtohet me një ftesë publike për bashkëpunim organeve të medias audiovizive, medias së shkruar, medias *online* dhe asaj elektronike, të cilat kanë në fokus të angazhimit të tyre trajtimin e çështjeve që lidhen me 3 fushat kryesore, që janë objekt i punës së këtij komisioni: mirëqeverisja, antikorrupsioni dhe sundimi i ligjit, për të shprehur interesin për përfshirje aktive në aktivitetet e organizuara nga komisioni i posaçëm parlamentar, si edhe për të ofruar kontributet e tyre në këtë proces pranë grupit të ekspertëve.

Qëllimi i këtij projektvendimi është për ta zgjeruar gjithëpërfshirjen, ekspertizën, por edhe për ta përfshirë më mirë oponencën kritike për çështje të tilla kaq të rëndësishme. Kjo do të thotë se ne po i bëjmë një ftesë publike për bashkëpunim, e cila do të botohet më pas edhe në faqen e komisionit dhe të Kuvendit, e cila fton ato medie, që kanë qenë dhe janë të angazhuara, për të mos i përmendur me emra dhe për të mos i identifikuar, sepse, e para, mund të jetë një listë shumë e gjatë dhe e dyta, mund të bëjmë ndonjë gabim, duke harruar dikë, siç ndodh rëndom në të tilla raste. Secila nga ato që dëshiron të jetë pjesë e këtij procesi, të vendosë në dispozicion shkrime, analiza dhe komente, që kanë bërë në këto vite për çështje të tilla me interes të veçantë, siç janë këto 3 fusha: mirëqeverisja, antikorrupsioni dhe sundimi i ligjit, njëkohësisht të japin opinionin dhe vlerësimin e tyre, tashmë jo thjesht për të informuar publikun, por për të kontribuar dhe për të adresuar çështje që kanë të bëjnë me këto 3 fusha, që janë objekt i punës së komisionit. Natyrisht, është në çmimin e secilit prej tyre të shprehë interesin për të kontribuar me një prani permanente përfaqësuesish pranë grupit të ekspertëve, por jo si pjesë e tyre; së dyti, për të marrë pjesë në tryezat e debatit që do të organizojmë dhe së treti, për të ofruar kontribute që janë pjesë normale e veprimtarisë së tyre, që mund të mos kenë qenë në vëmendjen tonë apo të institucioneve përgjegjëse gjatë këtyre viteve, por në vlerësimin e tyre kanë interes publik. Kjo besoj se do të jetë një vlerë e shtuar dhe një kontribut i rëndësishëm, në mënyrë të veçantë, në procesin e hartimit të analizës dhe më pas për planin e veprimit. Kjo është në thelb edhe në formë përmbajta e këtij projektvendimi.

A ka komente për këtë?

Po, fjala për zonjën Ekonomi.

Milva Ekonomi – Në fakt, unë nuk kam ndonjë koment. Mendoja që lista do të ishte shumë e gjatë, por po shikoja vendimin, që edhe forma e thirrjes është organizuar ndryshe nga të tjerat. Pra, si fillim ato shprehin interesin dhe më pas ne i thërrasim në nëngrupet tona të punës. Kështu që, e kam të qartë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – ... të interesit, sepse janë numër i pafundmë, nga ato që dëshirojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush shpreh interesin dhe thotë se e ndjej të nevojshme të kontribuoj, edhe ne e mbajmë parasysh se në debatet publike ato kanë një ftesë, jo thjesht për të pasqyruar aktivitetin, por për të qenë prezentë, për të qenë aktorë të tryezave, dhe për të kontribuar përmes komenteve, vlerësimeve, propozimeve dhe kritikave që mund të adresojnë për çështje të caktuara. Në qoftë se ka ndonjë formulë tjetër, do ta shikojmë në ndërtim, por ne do ta bëjmë publike, sepse është e pamundur t'i thërrasim të gjithë se secili mund të ndihet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Ndoshta përshkrimet duhet t'i diskutojmë pak, sepse këto mediet shkruajnë çdo ditë, pafund, dhe ju thatë pak më parë se janë të ftuar të sjellin shkrime, dhe nuk e di se sa duhet t'i konsiderojmë.

Fatmir Xhafaj – Nuk e kisha thjesht për shkrime të natyrës informative, por për analiza që mund të kenë bërë në këtë fushë, mund të kenë vëzhgime afatgjata, të cilat mundet të çojnë në disa përfundime, e para, për të njohur fenomenet, që mund të kenë qenë jashtë vëmendjes sonë në një periudhë të caktuar, dhe duke ardhur si kontribut në këtë moment që ne jemi të fokusuar në çështje të tilla...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sondazhet që mund të kenë. Ka të drejtë Klotilda. Pra, çfarë kanë për të pasqyruar, se nuk dua të marr raste konkrete, se ka që kanë bërë analiza për çështjet e korrupsionit në numra të tërë apo me sundimin e ligjit dhe mirëqeverisjen. Kjo mbetet në qasjen e tyre.

A jemi dakord edhe me këtë projektvendim?

Miratohet.

Faleminderit!

Këto ishin 3 vendimet që kishim parashikuar për mbledhjen e sotme të komisionit. A ka dikush diçka për të shtuar në fund?

Atëherë e mbyllim. Edhe një herë faleminderit! Faleminderit edhe stafit!

Për mbledhjen e ardhshme do t'ju njoftojmë shumë shpejt.

MBYLLET MBLEDHJA

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

**Koordinator i Komisionit
Elvi Prifti**